

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE VLORE  
NOTER AMARDA B. SHANAJ**



V2021062180104856615

**DATE 29/06/2021  
NR REP 2155**



**VËRTETIM NËNSHKRIMI**

Sot, më datë 29 Qershor 2021 para meje Notere AMARDA B. SHANAJ, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore VLORE, me zyrë në adresën Fier, 29 NENTORI, DERSVISH HEKALI, ZK.8533, NR.6/661, u paraqit personalisht:

**DEKLARUESI:**

**Sokol Çepele**, atësia Aziz, amësia Donika, shtetas Shqiptar, lindur në Roskovec, Fier dhe banues në ROSKOVEC, me adresë Fotografit 01550014; Nd. 9; H. 1; Roskovec; Roskovec; 9306; Roskovec, lindur më 08/02/1980, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036624984 dhe nr. personal I00208016R.

Subjekti i mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noteres, "Akt Themelimi i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "TOP AUTO MOTORS", bashkëlidhur.

Unë Noteri/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTER**

**AMARDA B. SHANAJ**

*Amarde Shanaj*

**AKTI I THEMELIMIT  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"TOP AUTO MOTORS" SHPK.**

Sot më 28 Qershor 2021 (dymijë e njëzetë e një), Fier, une i nënshkruari,

- (i) **Sokol Çepele**, atësia Aziz, amësia Donika, shtetas Shqiptar, lindur në Roskovec, Fier dhe banues në ROSKOVEC, me adresë Fotografit, Roskovec, lindur më 08/02/1980, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, posedues i Leternjoftimit me ID nr. 036624984 dhe nr. personal I00208016R .

Themeloj një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas legjislacionit Shqiptar në fuqi, dhe në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë Akt Themelimi dhe në Statutin e Shoqërisë.

**Neni 1**

**Emertimi**

- 1.1 Themelohet një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emertimin "TOP AUTO MOTORS" Shpk. (në vijim e quajtur "Shoqëria").
- 1.2 Shoqëria ushtron aktivitetin e saj në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" ("Ligji Tregtar"), të ndryshuar, legjislacionin shqiptar në fuqi dhe me Statutin e Shoqërisë.
- 1.3 Shoqëria do të fitojë personalitet juridik pas regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

**Neni 2**

**Objekti i Shoqërisë**

2.1 Shoqëria ka për objekt dhe qëllim të saj aktivitetet e mëposhtme: Import-eksport dhe tregtim të pjeseve të reja dhe të përdorura për automjete. Import-eksport dhe tregtim të automjeteve të reja dhe të përdorura. Ngritja e një aktiviteti tregtar e shërbimesh riparimi për të gjitha llojet e markave të automjeteve. Importimit të të gjitha llojeve të automjeteve dhe të gjitha markave. Shitjes me shumicë e pakicë të automjeteve. Organizmit të shërbimit të servisit universal për të gjitha markat e automjeteve. Shitjes me shumicë e pakicë të pjeseve të këmbimit, gomave, nyjeve, agregateve të automjeteve të të gjitha markave. Kryerjes së servisit universal për të gjitha llojet e automjeteve. Shërbim parkingu për mjete të ndryshme dhe mjete të tonazheve të ndryshme. Asgjësim të 2 mbetjeve. Pastrim, grumbullim, përpunim, transport dhe asgjësimi mbetjeve spitalore apo mbetjeve të tjera të ngjashme, sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara me ligj. Kryerjes të të gjitha shërbimeve të tjera ndihmëse të nevojshme që plotësojnë kryerjen e aktivitetit në fjalë dhe që nuk bien ndesh me ligjet shqiptare në fuqi. Qiradhenia e automjeteve të të gjitha llojeve, ngritja e rrjetit të qiradhenies së automjeteve në të gjithë territorin e Shqipërisë. Ofrim shërbim taksie. Import-eksport të pajisjeve elektro-shtepiake, produkte elektrike, goma makinash, vegla pune etj. Organizimin e një rrjeti njesish tregtare dhe riparues të cilat do ushtrorjnë veprimtarinë e tyre në përputhje me veprimtarinë. Transport mallrash brenda dhe jashtë vendit për vete dhe për të tjerë. Tregtim të pasiveve elektronike. Tregtim goma, bateri, alkool, vajra lubrifikante, antifrizë, graso etj. Të gjitha produktet të fushave: IT dhe telekomunikacionit, printera, kopjuterat, UPS, kancelerike dhe tonera, mobilje dhe pajisje për

zyra, elektrike, energjetike, hidraulike, mekanike, materiale dhe pajisje elektromjeksore, sisteme te energjise diellore, elektroshtepiake, sisteme te kondicionimit dhe ngohje ftohje e ajrit, ashensore, kaldaja, gjeneratore, elektroshtepiake, hidrosanitare, produkte te pastrimit, materiale te ndertimit, si dhe te artikujve te tjere te ndryshem. Sherbime ne fushen e turizmit dhe udhetimeve, Agjensi transporti dhe udhetaresh brenda dhe jashte vendit per transport ne rruge tokesore detare dhe ajrore. Projektim, ndertim, rikonstruksion lysterje, bojra muri, metalesh, druri, mirembajtje, mbikqyrje, kolaudim, te veprave civile dhe industriale. Tregti te artikujve te bute per perdorim spitalor, hoteleri, shkolla etj, F.V. te vetratave te ndryshme te xhamit, me profile druri e metalike, dyer dhe dritare druri e metalike te cdo lloji. Tregetim dhe F.V. te portave dhe trareve elektronike. Tregetim te gureve dekorative dhe te tjera te ngjashme. Artikuj te kancelarise, letres. Realizim sherbimesh ne fushen gjelberimit, pastrimit te ambienteve te brendeshme dhe te jashteme. Tregtim te artikujve te pastrimit, detergjente, denzifektanete, etj. Vegla te ndryshme pune. Sherbime karroatreci, tregtim, riparim, mbushje me gaz te kondicionereve te automjeteve, lavazh, lysterje, stukime, drejtime te automjeteve, pike skrapit dhe mbledhje te te gjitha llojeve te metaleve dhe tregtimin e tyre Organizimin e panairave dhe ekspozitave per paraqitjen e automjeteve te te gjitha markave, berjen e publicitetit tregtar. Marrja pjese neper ankande dhe tendera, si dhe te beje sherbime qe kane lidhje me objektin e veprimtarise se saj. Blerje pasuri te luajtshme apo te paluajtshme, t'i marre ose t'i leshoje me qera, te marre tenderin e tyre. Shoqeria, mund te kryeje per permbushjen e qellimeve te saj cdo lloj operacioni tregtar, mund te vendose pasuri te luajtshme dhe te paluajtshme, t'a hipotekojte kete pasuri ne rregjistrin e pasurive te paluajtshme ne emer te saj. Mund te hyje ne tratativa dhe biznese me shoqeri te tjera qe kane te njejtin objekt veprimtarie per te realizuar fitime ne fushat e permendura ne kete nen. Perfitoje, transferoje, te marre apo jape me qera, te bleje dhe shese, si dhe te kontraktoje, te drejten e markes, patentes, licences, dhe te drejttat e tjera qe jane te ngjashme me keto. Shoqeria, sic mund te ushtroje punet qe tregohen ne objektin e veprimtarise se saj, brenda dhe jashte vendit, ashtu edhe mund te marre pjese, te perfitoje apo te transferoje nga/te palet e tjera, mund te marre pjese ne kapitalet e personave juridike dhe fizike, te vendit apo te huaj, te krijuar ose qe krijojen me qellim tregtie, industrie, etj, ne lidhje me keto fusha.

- 2.2 Me qellim realizimin e objektit te aktivitetit te saj, Shoqëria mund te kryeje operacione tregtare me pasuri te luajtshme dhe te paluajtshme, si dhe te administroje, te blejë, te shesë, te japë me qira shoqëri e aktiviteteteve te tyre si dhe te ketë interesa e pjesëmarrje ne shoqëri, konsorciume te themeluara apo ne themelim e sipër, qe kane objekt te ngjashëm me objektin e aktivitetit e Shoqërisë, ose qe i shërben realizimit te këtij objekti. Ne përgjithësi, Shoqëria mund te kryeje çdo veprimtari te nevojshme e te dobishme, te lejuar nga ligji për realizimin e objektit te aktivitetit te saj.

### **Neni 3 - Selia**

- 3.1 Selia e Shoqërisë ndodhet ne adresën: Roskovec, nr.pasurie 2/1085, Z.K 3196
- 3.2 Shoqëria mund te krijoje dege, zyra, filiale dhe te zhvilloje aktivitet ne vende te tjera, brenda ose jashtë territorit te Republikës se Shqipërisë me vendim te ortakeve te Shoqërisë, ne perputhje me dispozitat e ligjit perkates dhe statutit te shoqerise.

#### Neni 4 - Kohëzgjatja

- 4.1 Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e saj për një kohëzgjatje te pacaktuar duke filluar nga momenti i regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar te Republikës se Shqipërisë.
- 4.2 Prishja dhe likuidimi i Shoqërisë do te përcaktohet me vendim te Asamblesë se Ortakeve ne përputhje me dispozitat e këtij Statuti dhe legjislacionin ne fuqi.

#### Neni 5- Kapitali

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100.000,00 Leke (njqind mije Leke), i ndare ne 1 (nje) kuote . Keto kuota jane teresisht prone e Ortakeve te Shoqerise dhe do te depozitohen si kapital themeltar i Shoqerise "TOP AUTO MOTORS" ne Banken "Raiffeisen"Sh.a, pas regjistrimit te shoqerise ne QKR.

- 5.1 Kapitali i Shoqërisë apo çdo kontribut ne para për zmadhimin e kapitalit paguhet ne llogarinë bankare te Shoqërisë.
- 5.2 Kuotat janë te transferueshme sipas kushteve te përcaktuara ne Ligjin Tregtar dhe ne ketë Statut.
- 5.3 Përgjegjësia e ortakeve shtrihet deri ne vlerën e kontributit te tyre ne kapitalin e Shoqërisë.

#### Neni 6- Ortaket

- 6.1 Ortaku i Shoqërisë është si vijon:
  - Sokol Çepele, zotërues i 1 (nje) kuote, me vlere nominale 100.000 Leke (njqind mije), qe përfaqësojnë 100%, (njqind perqind) te kapitalit te Shoqërisë;
- 6.2 Adresa e ortakeve për efekt te marrëdhënieve te tyre me Shoqërinë, është ajo qe rezulton nga regjistri i ortakeve. Është detyrim i ortakeve te njoftojnë ndryshimin e adresës se tyre. Administratori ka për detyre te mbaje dhe përditësoje këtë regjistër.
- 6.3 Administratori i Shoqërisë "AUTO MOTORS" SH.P.K do të jetë **Z. Sokol Çepele**, atesia Aziz, shtetas shqiptar, i datëlindjes 08.02.1980, lindur në banues në Roskovec, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, posedues i letërnjoftimit me nr. Personal ID I00208016R

#### Neni 7- Asambleja e ortakeve

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar), organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

- Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;
  - Administratorët – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.
- 7.1 Ne baze te ligjeve dhe dispozitave te këtij Statuti, Asambleja e Përgjithshme e ortakeve te Shoqërisë është organi me i larte vendimmarrës i Shoqërisë. Ajo perfaqeson te gjithë ortaket dhe vendimet e saj, te marra ne perputhje me ligjin dhe kete Statut, jane detyruese per te gjithë ortaket, perfshire ata qe nuk marrin pjese ne votim dhe qe votojne kunder ketyre vendimeve.

- 7.2 Vendimet per çeshtjet e meposhtme te Shoqerise mund te miratohen ne mbledhjen e asamblese se pergjithshme te ortakeve ose nepermjet konsultimit me shkrim.

#### **Neni 8- Administrimi i Shoqerise**

- 8.1 Administrimi i Shoqerise do te kryhet nga nje Administrator.
- 8.2 Administratori do te emerohet nga asambleja e ortakeve dhe mund te shkarkohet ne çdo kohe me vendim te asamblese se ortakeve.
- 8.3 Administratori do te jete person fizik pa asnje kufizim per sa i perket kombesise se tij. Afati i emerimit te Administratorit do te caktohet ne momentin e emerimit te tyre por ky afat nuk mund te jete me i gjate se 5 (pese) vjet. Pa cenuar kete kufizim afati i emerimit te tyre mund te ripërterihet me vendim te asamblese se ortakeve.
- 8.4 Administratori do te rimbursohet per shpenzimet e kryera gjate ushtrimit te detyrave te tij. Asambleja e ortakeve mund te vendose te jape edhe shperblime vjetore.
- 8.5 Ne rast doreheqje Administratori do te njoftoje me shkrim asamblene e ortakeve. Doreheqja do te hyje ne fuqi ne momentin e emerimit te Administratorit te ri.
- 8.6 Administratori mund te ushtroje te gjitha kompetencat si dhe te kryeje te gjitha veprimet te cilat me ligj ose ne Statut nuk i rezervohen kompetencave te asamblese se ortakeve ose nuk kufizohen nga Statuti apo nga ligji i zbatueshem
- 8.7 Shoqeria perfaqesohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, të cilët i ushtrojnë këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqerise dhe legjislacionin ne fuqi

#### **Neni 9- Viti financiar dhe pasqyrat financiare**

- 10.1 Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 janar dhe mbyllet me 31 Dhjetor te çdo viti.
- 10.2 Ne perfundim te çdo viti financiar, Administratori harton pasqyrat financiare ne perputhje me ligjin.

#### **Neni 10- Prishja dhe Likuidimi**

- 11.1 Asambleja e ortakeve mund te vendose per prishjen e Shoqerise. Prishja e Shoqerise do te shoqerohet me likuidimin e saj.
- 11.2 Shoqeria vazhdon te ekzistojte si person juridik vetem per nevoja te likuidimit deri ne perfundim te ketij procesi dhe gjate likuidimit togfjaleshi "ne likuidim e siper" duhet te vihet pas emrit te Shoqerise.
- 11.3 Likuiduesi/t do te emerohet me vendim te Asamblese se ortakeve. Emerimi i likuiduesit/eve dhe procesi i likuidimit do te kryhen ne perputhje me dispozitat e ligjit shqiptar

#### **NENI 11**

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhëdmojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

**Neni 12- Ligji i Zbatueshem dhe Juridiksioni**

- 13.1 Per çeshtjet e parregulluara ne kete Akt Themelimi dhe nga Statuti i Shoqerise do te zbatohet Ligji nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar.
- 13.2 Çdo konflikt, divergjence, mosmarreveshje apo pretendim i çfaredolloji, sidoqe te kete lindur nga apo ne lidhje me kete Akt Themelimi, do t'i drejtohet dhe zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Fier

Ky Akt Themelimi i Shoqerise u hartua ne kater kopje ne gjuhen shqipe , me te njejten vlere.

**ORTAKU**

**Sokol Çepele**

SOKOL ÇEPELE

